

COLLEGE BOARD

# PSAT™ 8/9 Test Directions Translated into Albanian for Students 2020-2021

## Notes to the Proctor:

This document should be printed and distributed once students are seated.

Students may use this document to read translations of the directions that are read aloud or printed in their test book.

Students may keep this document open and on their desk during the entire test.

Students may **not** be given additional time, unless approved as a separate accommodation.

Collect this document from each student at the end of testing and securely destroy it.

## Table of Contents

Notes to the Proctor:	1
Notes to the Student	3
1 Before the Test Begins	4
1.1 Answer Sheet Distribution	6
1.2 Test Book Distribution	7
1.3 Completing the Certification Statement	8
1.4 Completing Test Book Information	8
1.5 Front Cover Directions	10
1.6 Back Cover Directions	11
2 Section 1: Reading Test	12
2.1 Section 1 Test Book Directions	13
2.2 Break Between Sections	13
3 Section 2: Writing and Language Test	13
3.1 Section 2 Test Book Directions	14
4 Section 3: Math Test – No Calculator	14
4.1 Section 3 Test Book Directions	16
4.2 Break Between Sections	17
5 Section 4: Math Test – Calculator	18
5.1 Section 4 Test Book Directions	19
6 Dismissal	20
6.1 Collecting Test Books and Other Test Materials	21
6.2 Finishing Up	21
6.3 Completing Answer Sheets	21
6.4 Collecting Answer Sheets and Dismissing Students	23

## Shënime për studentin

Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që kujdestari do t'i lexojë me zë, si dhe udhëzimeve të shkruara që gjenden në librat e testit tuaj. Përcillini udhëzimet derisa kujdestari juaj i lexon ato me zë në anglisht. Nëse keni pyetje rreth asaj se çfarë është duke lexuar kujdestari juaj, ju lutem ngrini dorën.

- Këto udhëzime të përkthyer mund të mos përshtaten fjalë për fjalë me atë që lexon kujdestari juaj. Mos u merakosni, kuptimi është i njëjtë.
- Kujdestari juaj mund të kapërcejë disa udhëzime që nuk vlejné për situatën tuaj të testimit.
- Mund ta mbani këtë dokument në tavolinë gjatë gjithë kohës së testimit por duhet t'ia ktheni kujdestarit tuaj pas testimit.
- MOS e përdorni këtë dokument si letër skrap.
- Në kohë të ndryshme, kujdestari juaj do të lajmërojë sa është koha e mbetur për pjesën, si dhe për pauzat kur të jetë e përshtatshme. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, këto lajmërime mund të dallojnë sa i përket kohës dhe pazave të listuara në këtë dokument të përkthyer. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj.
- Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, kujdestari i juaj mund të ju jep udhëzime shtesë në gjuhën angleze.
- Ikonat përdoren përgjatë tërë këtij dokumenti për të ju tërhequr vëmendjen në informata specifike:



Informatë e rëndësishme.



Udhëzimet e thëna nga kujdestari juaj.



Udhëzimet që përmban libri juaj i testimit

# 1 Para fillimit të testit

*Kujdestari juaj do të nisë duke thënë:*

- Mirë se vini në administrimin e PSAT 8/9. Ky test do të fokusohet në atë që tashmë e keni mësuar gjatë shkollës. Ju jep një mundësi të shihni se ku mund të ju nevojitet që të përmirësoheni në shkollë të mesme. Nëse jeni duke përdorur udhëzimet e shtypura, përdorini për të më ndjekur gjersa unë i jap udhëzimet.

Para se të nisim testin, do të lexoj disa udhëzime. Ju lutem dëgjoni me kujdes dhe ngriteni dorën nëse keni ndonjë pyetje. Mbani mend, roli im është të sigurohem që keni mundësinë më të mirë për të demonstruar shkathtësitë dhe njohuritë tuaja.

Për testin e sotëm mund të përdorni vetëm laps Numër 2 për të shënjuar fletën e përgjigjeve. Lapsat mekanikë nuk lejohen. Ju lutem ngriteni dorën nëse nuk keni laps Numër 2 dhe unë do t'ua jap një.

*Pastaj, kujdestari juaj do të thotë:*

- Kushtet e përgjithshme të College Board PSAT 8/9 përfshijnë rregulla dhe politika për të siguruar që të gjithë studentët të kenë një përvojë testuese të drejtë dhe të barabartë. Nëse ndokush shqetëson të tjerët ose përpiket të fitojë avantazh të padrejtë, do t'i kërkojë të largohet nga klasa dhe rezultatet e tyre do të anulohen. Atyre gjithashtu mund t'u ndalohet t'u nënshtrohen testeve tjera të College Board në të ardhmen.

*Kujdestari juaj do të listojë shembuj të sjelljes së keqe duke thënë:*

- Këtu kemi disa shembuj të avantazheve të padrejta:
  - Dhënia ose pranimit i çfarëdo lloji ndihme në test
  - Shikimi i librit të testit para se të fillojë koha
  - Shikimi i cilësdo pjese ose testi tjetër përveç atij në të cilin gjendemi aktualisht
  - Shënrimi ose ndryshimi i përgjigjeve pas përfundimit të kohës
  - Tentativa për të larguar materiale të testit nga klasa e testimit
  - Përdorimi i telefonit ose çfarëdo ndihme tjetër të paautorizuar gjatë testimit ose gjatë pauzave
  - Përdorimi i çelësit të përgjigjeve ose ndarja e përgjigjeve me këdo gjatë ose pas testit
  - Shkuarja te dollapi me dry ose largimi nga ndërtesa gjatë testit
  - Tentimi për t'iu nënshtrohet testit për dikë tjetër
  - Ngrënia ose pirja gjatë testimit pa akomodim të miratuar për të bërë këtë
  - Shkaktim shqetësimi
  - Mosndjekja e procedurave të testimit

Këto politika ndihmojnë që të sigurohet se përvoja e testimit tuaj sot të jetë e drejtë dhe se mund të fokusoheni në testin tuaj pa shpërqëndrime.

Nëse shihni ndonjë gjë që ju shqetëson, ju lutem bisedoni me mua ose ndonjë anëtar tjetër stafi pas testit dhe do të ju ndihmojmë lidhur me hapat e radhës.

**Kujdestari juaj do të lexojë vetëm një opsion, skriptën A ose B, që vijon.**

*(A) Nëse shkolla juaj ka mbledhur gjërat personale, kujdestari juaj do të thotë:*

- Deri tani ju do të duhej të kishit dorëzuar të gjithë telefonat dhe çfarëdo pajisje tjetër elektronike. Nëse ndokush ende ka ndonjë pajisje elektronike të çfarëdo lloji, përfshirë orë dore të mençur ose monitorues fitnesi, ju lutem çaktivizoni alarmet, fikini dhe mi dorëzoni mua tani. Do t'u kthehen në fund të testit.

*(B) Nëse shkolla juaj ka mbledhur gjërat personale, kujdestari juaj do të thotë:*

- Në këtë kohë, nëse keni telefon apo ndonjë pajisje tjetër elektronike në posedim, përfshirë orë dore të mençur ose monitorues fitnesi, duhet t'i çaktivizoni alarmet, t'i fikni pajisjet dhe ti fusni në qese apo çantë e ti vendosni anash në klasë deri në përfundim të testit. Nëse ju është aprovuar shfrytëzimi i ndonjë sendi si ndihmë, përfshijeni me sendet të cilat i mbani në ulësen tuaj. Nëse ju duhet qese për ta vendosur telefonin, ngriteni dorën dhe unë do t'ua jap një.

*Kujdestari juaj do ta konfirmojë se nuk lejohen tpajisje elektronike duke thënë:*

- Çfarëdo pajisje elektronike që nuk është e fikur ose e lënë larg mund të merret dhe të kontrollohet përmbajtja e tyre si pjesë e një hetimi. Nëse shiheni me ndonjë pajisje ose nëse pajisja juaj bën ndonjë zhurmë ose krijon shqetësim ndërsa është në posedimin tuaj, do të më duhet të ju largoj nga testimit. Nga tani e tutje, do ta largoj cilindo student që e shoh me telefon, orë dore të mençur ose pajisje tjetër elektronike.

*Pastaj, kujdestari juaj do të thotë:*

- Faleminderit që u kushtuat vëmendje këtyre udhëzimeve deri tani. Tani do të përgatitemi për të filluar testin.
  - Largoni çdo gjë nga tavolina juaj përveç lapsave Numër 2, kalkulatorit të pranueshëm dhe kalkulatorit rezervë nëse keni një të tillë dhe çfarëdo pajisjeje testimi të miratuar. Nëse jeni duke përdorur udhëzimet e shtypura për test ose një fjalor nga fjala në fjalë, mbani këto sende në tavolinën tuaj.
  - Nëse keni sjellë me vete bateri shtesë, pije, ose zamra, vendosni në dyshe me nën tavolinë.
  - Nëse në tavolinë ju ka mbetur ndonjë qese ose çantë shpine, mbyllini ato dhe vendosini anash në klasë deri në përfundim të testimit.

*Kur të gjithë studentët të jenë gati kujdestari juaj do të thotë:*

- Ju lutem rrini ulur në qetësi derisa të shoh përreth dhe të sigurohem se të gjithë jeni duke përdorur kalkulatorë të pranueshëm.

*Pastaj, kujdestari juaj do të thotë:*

- Ju lutem mbani mend që nuk mund të ndani ose shkëmbeni kalkulatorët në asnjë moment. Vendosni kalkulatorët tuaj nën tavolinë tani. Nuk do të ju nevojiten deri në një pjesë të mëvonshme.

## 1.1 Shpërndarja e fletës së përgjigjeve

*Pas shpërndarjes së fletëve të përgjigjeve, kujdestari juaj do të thotë:*

- 🔊 Këto janë fletët e përgjigjeve që do t'i përdorni për të shënuar përgjigjet e juaja në test. Nëse jeni duke përdorur një fletë të përgjigjeve me blloqe të mëdha, ju lutem lexoni udhëzimet në faqen 1 të fletës suaj të përgjigjeve rreth asaj se si t'i shënoni përgjigjet e juaja. Numrat e faqeve tuaja do të jenë të ndryshëm nga numrat që unë do t'i lajmëroj, por numrat e fushave do të jenë të njëjtë si numrat e fushave që i jap për të gjithë. Do t'i shënjonit katrorët me një X në vend se të mbushni flluskat. Ngriteni dorën nëse keni nevojë për ndihmë në çfarëdo kohe.

**Kujdestari juaj do të lexojë vetëm një opsion, skriptën A ose B, që vijon.**

*(A) Nëse të gjithë studentët kanë fletët e përgjigjeve me informatat e tyre personale, kujdestari i juaj do të thotë:*

- 🔊 Të gjithë këtu duhet të kenë një fletë të përgjigjeve me etiketë dhe/ose informacion të shtypur dhe flluskues në të. Ju lutem kontrolloni se keni fletën e saktë të përgjigjeve duke u siguruar që tregon emrin e saktë ligjor tuajin dhe datën e lindjes. Ngriteni dorën nëse keni fletën e gabuar të përgjigjeve ose nëse gjeni gabime në etiketë.

*(B) Nëse disa studentë nuk i kanë plotësuar informatat personale në fletët e tyre të përgjigjeve, kujdestari juaj do të thotë:*

- 🔊 Disa nga ju tashmë mund të keni një etiketë dhe/ose informacion të shtypur dhe flluskues në fletën e përgjigjeve që sapo ua dhashë. Nëse është kështu, ju lutem kontrolloni a e keni fletën e duhur të përgjigjeve duke u siguruar se informatat në fletën tuaj të përgjigjeve janë të sakta. Nëse është e saktë, ju lutem qëndroni ulur të qetë për disa minuta derisa të udhëzojë studentët tjerë për të plotësuar fushat e caktuara në fletët e përgjigjeve të tyre. Nëse cilado informatë në fletën e përgjigjeve tuaja është e pasaktë, ngriteni dorën.

*Për studentët që kanë nevojë të plotësojnë informata në fletët e tyre të përgjigjeve, për fushën 1, kujdestari juaj do të thotë:*

- 🔊 Filloni duke plotësuar mbiemrin ligjor, emrin dhe inicialin e mesëm nëse keni një të tillë. Përfshini hapësirat, vizat ose apostrofët nëse janë pjesë e emrit tuaj. Në kuti shtypni shkronja kapitale, pastaj mbushni flluskat përkatëse. Sigurohuni që çdo shenjë është e errët dhe e mbush tërësisht flluskën. Kur të përfundoni ngriteni shikimin lart.

*Për fushën 2, kujdestari juaj do të thotë:*

- 🔊 Për fushën 2, nëse e vijoni këtë shkollë, mbushni flluskën për "Yes" („Po“). Kushdo që nuk e vijon këtë shkollë rregullisht duhet të mbushni flluskën që vlen për ju. Ngriteni dorën nëse keni ndonjë pyetje.

*Për fushat 3 dhe 4, kujdestari juaj do të thotë:*

- 🔊 Për fushat 3 dhe 4, nëse e vijoni këtë shkollë, shkruani me shkronja shtypi emrin e shkollës suaj, qytetin dhe shtetin në fushën 3, pastaj shkruani me shkronja shtypi kodin tonë 6 shifror të shkollës \_\_\_\_\_ në fushën 4 dhe mbushni flluskat përkatëse. Nëse nuk e vijoni këtë shkollë rregullisht, ngriteni dorën dhe unë do të vij t'ua jap kodin e saktë për ta plotësuar në fushën 4. Kur të përfundoni ngriteni shikimin lart.

**Nëse shkolla juaj nuk përdor numra letërnjoftimi për studentë, kujdestari juaj do ta kapërcejë këtë fushë.**

*Nëse shkolla juaj përdorë numra letërnjoftimi për studentë, për fushën 5, kujdestari juaj do të thotë:*

- Në fushën 5, shkruani me shkronja shtypi dhe plotësoni flluskat për numrin e letërnjoftimit të studentit, duke filluar me kolonën e parë në të majtë. Nëse ka shkronja në numrin e letërnjoftimit tuaj mos i përfshini ato dhe futni vetëm numrat pa hapësira mes tyre. Nëse nuk e dini numrin e letërnjoftimit tuaj të studentit, ngriteni dorën. Kur të përfundoni ngriteni shikimin lart.

*Për fushën 6, kujdestari juaj do të thotë:*

- Plotësoni nivelin e klasës tuaj aktuale në fushën 6.

*Për fushën 7, kujdestari juaj do të thotë:*

- Përfundo fushën 7.

*Për fushën 8, kujdestari juaj do të thotë:*

- Për datën tuaj të lindjes mbushni flluskën për muajin në të cilin keni lindur. Në fletët e përgjigjeve me blloqe të mëdha, plotësoni shifrat për muajin, duke filluar me zero nëse muaji ka vetëm 1 shifër. Në vijim, shkruani numrin 2 shifror për ditën në të cilën keni lindur, duke filluar me zero nëse dita është më pak se 10. Pastaj shkruani 2 shifrat e vitit në të cilin keni lindur. Mbushni flluskat përkatëse dhe ngriteni shikimin kur të përfundoni.

*Para shpërndarjes së librave të testit, kujdestari juaj do të thotë:*

- Nëse keni fusha tjera që duhet ti plotësoni në pjesën që nuk është test të fletës suaj të përgjigjeve, do të keni mundësi t'i plotësoni ato pasi të përfundojë testi.

## 1.2 Shpërndarja e Librit të Testit

*Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:*

- Tani do t'ju jap librat e testit. Kur të merrni librin e testit, mos e hapni atë.

*Kur të gjithë studentët të kenë librat e testit, kujdestari juaj do të thotë:*

- Ktheni përmbys librin e testit dhe lexoni kopertinën e prapme. Ka informata të rëndësishme për testin dhe se si të shënohen si duhet përgjigjet tuaja.

A keni pyetje për atë që sapo lexuat?

*Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:*

- Në anën e prapme të librit të testit, shkruani qartë me shkronja të shtypit emrin tuaj, kodin dhe emrin e kësaj shkolle dhe kodin ose emrin e kësaj klase testimit, të cilat i kam postuar për ju.

*Për studentët që përdorin USB memorie (flash drive), kujdestari juaj do të thotë:*

- Nëse jeni duke përdorur formatin e USB-së, duhet të siguroheni që këto informata janë edhe në pakon për USB.

*Kujdestari juaj do të japë udhëzime shtesë për shënjimin e përgjigjeve duke thënë:*



Është e rëndësishme të ndiqni udhëzimet për shënjimin e përgjigjeve në mënyrë që të mund të llogariten pikët në fletën e përgjigjeve tuaja. Do t'i theksoj pikat më të rëndësishme për t'u siguruar se janë të qarta. Ju lutem dëgjoni me kujdes.

- Shënjoni të gjitha përgjigjet tuaja në fletën e përgjigjeve. Librin e testit mund ta përdorni për punë skrap, por vetëm përgjigjet e shënuara në fletën e përgjigjeve mund të llogariten, përveç nëse ju është miratuar shënimi i tyre në librin e testit.
- Nëse keni marrë miratimin për t'i shënuar përgjigjet e juaja në librin e testit, rrethoni shkronjën e përgjigjes së zgjedhur në librin e testit. Rrethoni vetëm 1 përgjigje për secilën pyetje. Nëse ndryshoni mendje, fshijeni sa më shumë që mundeni. Nëse nuk jeni të miratuar për këtë akomodim, sigurohuni të shënoni përgjigjet e juaja në fletën tuaj të përgjigjeve.
- Pasi të përfundojë koha, nuk mund të transferoni përgjigje nga libri juaj i testit në fletën tuaj të përgjigjeve ose të mbushni flluskat.
- Sigurohuni të përdorni laps Numër 2. Mos përdorni laps kimik, laps me ngjyrë, ose laps mekanik.
- Shënjoni 1 përgjigje për çdo pyetje dhe mbushni plotësisht dhe errësoni flluskat në fletën e përgjigjeve.
- Në fletën e përgjigjeve mos bëni shenja tjera përveç përgjigjeve tuaja. Shenjat tjera në fletën tuaj të përgjigjeve do të ndërhyjnë në rezultat.
- Nëse fshini diçka, fshijeni tërësisht. Fshirjet e paplota mund të llogariten si përgjigje të synuara.

### 1.3 Plotësimi i Deklaratës së Vërtetimit

*Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:*



Tani, ju lutem gjeni Certification Statement (Deklaratën e Vërtetimit) në anën e pasme të fletës suaj të përgjigjeve.

Duke nënshkruar deklaratën, ju pajtoheni të mos ndani asnjë përmbajtje të testit me askënd, përmes çfarëdo mjeti, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në postë elektronike, mesazhe tekstuale, postime në internet, ose përdorime tjera të internetit. Nëse bëni këtë mund të rezultojë me anulim të rezultatit ose me sanksione tjera të mundshme. Këto kushte janë të përshkruara në *PSAT 8/9 Student Guide (Udhërrëfyesin për Studentë të PSAT 8/9)*.

Lexoni deklaratën dhe informatat në fletën tuaj të përgjigjeve, pastaj nënshkruani emrin e plotë siç do ta bënit në një dokument zyrtar. Nën nënshkrimin tuaj, shkruani emrin tuaj me shkronja shtypi dhe shënioni datën e sotme.

Kur të përfundoni lëshoni lapsat poshtë.

### 1.4 Plotësimi i Informatave të Librit të Testit

*Për fushat A dhe B, Form Code (Kodin e Formularit) dhe Test ID (ID e Testit), kujdestari juaj do të thotë:*



Gjej fushat A dhe B në pjesën e pasme të fletës suaj të përgjigjeve. Gjeni Form Code (Kodin e Formularit) dhe Test ID (ID-në e Testit) në anën e pasme të formatit të testit në të cilin jeni duke u testuar—pra në, librin e testit, skriptën e lexuesit (të dhënë lexuesit tuaj), librit Braille,



ose pakos në USB. Kopjoni Form Code (Kodin e Formularit) dhe Test ID (ID-në e Testit) saktësisht siç paraqiten në testin në fushat A dhe B në fletën tuaj të përgjigjeve dhe mbushni flluskat e duhura. Ju lutem ngriteni shikimin lart kur të keni përfunduar.

**Fusha C duhet të plotësohet vetëm nëse librat tuaj të testit kanë numra serik në këndin e sipërm të djathtë të ballinës. Nëse librat tuaj të testit nuk kanë numra serik, kujdestari juaj do ta kapërcejë paragrafin e radhës.**

*Për testimin në Prill, për fushën C, kujdestari juaj do të thotë:*

- Shihni në ballinën e librit të testit ose formatit të testit. Gjeni numrin në këndin e epërm të djathtë të etiketuar "Test Book Serial Number" (Numri Serik i Librit të Testit). Shënoni numrin serik në fushën C në fletën e përgjigjeve dhe mbushni flluskat përkatëse.

*Kujdestari juaj do t'u kërkojë studentëve të kontrollojnë kodet që kanë shënuar duke thënë:*

- Për të parandaluar problemet me marrjen e rezultateve tuaja, kontrolloni fushat për Form Code (Kodin e Formularit) dhe Test ID (ID-në e Testit) për t'u siguruar se i keni shënuar saktë.

**Nëse librat tuaj të testit nuk kanë numra serik, kujdestari juaj do ta kapërcejë paragrafin e radhës.**

*Për testimin në Prill, kujdestari juaj do të thotë:*

- Ju lutem kontrolloni se a është plotësuar saktë edhe Test Book Serial Number (Numri Serik i Librit të Testit).

*Nëse shkolla juaj përdor kode të klasave testuese, për fushën D, kujdestari juaj do të thotë:*

- Në fushën D, shkruani kodin e klasës testuese që e kam postuar, pastaj mbushni flluskat.

*Nëse shkolla juaj përdor kode opsionale, për fushën E, kujdestari juaj do të thotë:*

- Për fushën E, do të lexoj me zë emrat e studentëve të cilëve u është caktuar secili kod. Kur të dëgjoni emrin tuaj, shënoni kodin të cilin e kam lajmëruar për grupin tuaj. Ngriteni dorën nëse keni nevojë ta përsërisë kodin që ju është caktuar. Nëse nuk e vijoni këtë shkollë, fushën E lëreni të zbrastë.

*Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:*

- Testin do ta filloni pas pak minutave, pasi të lexoj edhe disa pika përfundimtare.

Gjatë testit, mbani fletën e përgjigjeve dhe librin e testit rrafsh në tavolinë. Nëse gjeni ndonjë gabim në fletën e përgjigjeve ose librin e testit, siç janë mungesa e një faqeje, ngriteni dorën në atë moment. Do të eci përreth nëpër klasë për të kontrolluar progresin tuaj.

Për PSAT 8/9, mund të punoni vetëm në një pjesë në të njëjtën kohë. Nuk lejoheni të kaloni në pjesën tjetër derisa të ju thuhet të veproni kështu. Kjo mund të jetë ndryshe nga sa jeni mësuar, kështu që sigurohuni të mos kaloni para ose të mos shikoni prapa në një pjesë të mëparshme, edhe nëse e përfundoni pjesën e tanishme.

Fletët e përgjigjeve dhe librat e testeve nuk duhet të largohen nga klasat e testimit asnjëherë.

Nëse keni ndonjë pyetje rreth procedurave të testimit, ju lutem bëni ato tani. Gjatë pjesëve të testit me kohë të kufizuar nuk do të mund të përgjigjem pyetjeve.

## 1.5 Udhëzimet në Ballinë



Në vijim është përkthimi i ballinës së librit të testit.

---

### PËRKUJTUES TË RËNDËSISHËM

1

Për test kërkohet laps Nr. 2. Mos përdorni laps mekanik ose laps kimik.

2

Ndarja e pyetjeve ose përgjigjeve të testit me këdo është shkelje e Kushteve tona të përgjithshme. Nëse i shkelni Kushtet e Përgjithshme, mund të anulohet rezultatet tuaja dhe t'ua ndalojmë t'u nënshtroheni vlerësimeve në të ardhmen.

KY LIBËR TESTI NUK DUHET TË LARGOHET NGA KLASA. RIPRODHIMI I PAAUTORIZUAR OSE PËRDORIMI I CILËSDO PJESE TË KËTIJ LIBËR TESTI ËSHTË I NDALUAR.

© 2020 College Board. College Board dhe logoja e boçës së dushkut janë marka tregtare të regjistruara të College Board. PSAT është markë tregtare në pronësi të College Board.

---

## 1.6 Udhëzimet në kopertinën e pasme



Në vijim është përkthimi i ballinës së librit të testit. Kur të udhëzoheni, duhet të shkruani në librin e testit ose në fletën e përgjigjeve, jo në këtë dokument.

EMRI JUAJ

(ME SHKRONJA TË SHTYPIT)

MBIEMRI

EMRI

INICIALI I MESËM

SHKOLLA

KODI I SHKOLLËS

EMRI I SHKOLLËS

KODI / EMRI I KLASËS SË TESTIMIT

## PSAT 8/9

### UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

- Mund të punoni në vetëm një pjesë në të njëjtën kohë.
- Nëse përfundoni një pjesë para përfundimit të kohës, kontrolloni punën tuaj në atë pjesë. MOS kaloni në ndonjë pjesë tjetër.

### SHËNJIMI I PËRGJIGJEVE

- Sigurohuni të shënjoni faqen e përgjigjeve si duhet.

Shenja e plotë:

Shenjat jo të plota:



- Duhet të përdorni laps Nr. 2.
- Me kujdes shënjoni vetëm një përgjigje për çdo pyetje.
- Sigurohuni të mbushni tërë flluskën plotësisht dhe ta errësoni.
- Mos bëni ndonjë shenjë rasti në fletën e përgjigjeve.
- Nëse fshini diçka, fshijeni tërësisht. Fshirjet e paplota mund të llogariten si përgjigje të synuara.
- Përdorni vetëm hapësirat e përgjigjeve që përkojnë me numrat e pyetjeve.

### PËRDORIMI I LIBRIT TUAJ TË TESTIT

- Mund ta përdorni librin e testit për punë skrap, por nuk merrni pikë për asgjë që shkruani në librin e testit.
- Pasi të përfundojë koha, nuk mund të transferoni përgjigje nga libri juaj i testit në fletën tuaj të përgjigjeve ose të mbushni flluskat.
- Nuk duhet të palosni apo largoni faqe apo pjesë të faqeve nga ky libër, ose të merrni librin apo fletën e përgjigjeve nga klasa e testimit.

### FITIMI I PIKËVE

- Për çdo përgjigje të saktë do të merrni një pikë.
- Nuk humbni pikë për përgjigje të gabuara; prandaj, duhet të përqipeni të përgjigjen në secilën pyetje edhe nëse nuk jeni të sigurt për përgjigjen e saktë.

### ME RËNDËSI

Kodet e mëposhtme janë unike për librin e testit tuaj. Kopjoni ato në fletën tuaj të përgjigjeve në fushat A dhe B dhe mbushni flluskat përkatëse saktësisht siç tregohen.

A Form Code						
A	A	A	A	0	0	0
B	B	B	B	1	1	1
C	C	C	C	2	2	2
D	D	D	D	3	3	3
E	E	E	E	4	4	4
F	F	F	F	5	5	5
G	G	G	G	6	6	6
H	H	H	H	7	7	7
I	I	I	I	8	8	8
J	J	J	J	9	9	9
K	K	K	K			
L	L	L	L			
M	M	M	M			
N	N	N	N			
O	O	O	O			
P	P	P	P			
Q	Q	Q	Q			
R	R	R	R			
S	S	S	S			
T	T	T	T			
U	U	U	U			
V	V	V	V			
W	W	W	W			
X	X	X	X			
Y	Y	Y	Y			
Z	Z	Z	Z			

B Test ID						
0	0	0	0	0	0	0
1	1	1	1	1	1	1
2	2	2	2	2	2	2
3	3	3	3	3	3	3
4	4	4	4	4	4	4
5	5	5	5	5	5	5
6	6	6	6	6	6	6
7	7	7	7	7	7	7
8	8	8	8	8	8	8
9	9	9	9	9	9	9

Idetë që përmbajnë pasazhet për këtë test, disa nga të cilat janë nxjerrë ose përshtatur nga materialet e publikuara, nuk i paraqesin domosdo mendimet e College Board.

**MOS E HAPNI KËTË LIBËR DERISA KUJDESTARI TË JU THOTË TA BËNI KËTË.**

## 2 Pjesa 1: Testi i leximit



Koha standarde për Pjesën 1 është **55 minuta**, me një **pauzë prej 5-minuta** në fund të pjesës. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të librit të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

*Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:*

- Do të fillojmë testimin me Pjesën 1, Testi i Leximit Pasi të fillojmë, do të keni 55 minuta për të punuar në Pjesën 1. Do të bëjmë një pushim 5 minuta kur të përfundojë kjo pjesë. Do t'i postoj kohën e fillimit dhe kohën e përfundimit, dhe do t'ju njoftoj kur të kalojë gjysma e kohës së pjesës dhe kur të mbeten edhe 5 minuta.

Ju lutem hapni fletën e përgjigjeve të Pjesa 1 në faqen 3. Mos filloni punë derisa të ju them unë. Mbani fletën e përgjigjeve të hapur dhe rrafsh në tavolinë. Mos i palosni faqet prapa. Sigurohuni të shënjoni përgjigjet tuaja në Pjesën 1 të fletës së përgjigjeve dhe kontrolloni që përgjigjet e juaja të jenë në hapësirat e duhura për secilën pyetje me numër. Nëse e kaloni një pyetje për t'iu kthyer më vonë, sigurohuni të lini atë vijë të zbrastë në fletën e përgjigjeve. Nëse e ndryshoni përgjigjen tuaj, fshijeni sa më plotë që të jetë e mundur.

Nëse përfundoni para se të them se i erdhi fundi kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk duhet të kaloni në asnjë pjesë tjetër. Ju nuk humbni pikë për përgjigje të pasakta, kështu që përpquni të përgjigjeni në secilën pyetje edhe nëse nuk jeni të sigurt për përgjigjen e saktë.

Tani, ju lutem hapni librin tuaj të testit të Pjesa 1. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Fat të mbarë, të gjithë. Koha fillon tani.

*Pas 30 minutave, kujdestari juaj do të thotë:*

- Ju kanë mbetur edhe 25 minuta në Pjesën 1.

*Pas 50 minutave, kujdestari juaj do të thotë:*

- Ju kanë mbetur edhe 5 minuta në Pjesën 1.

*Pas saktësisht 55 minutave, kujdestari juaj do të thotë:*

- Ju lutem ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

Për të ju ndihmuar të gjeni shpejt vendin tuaj pas pauzës, vendosni fletën e përgjigjeve mbi faqen e librit të testit ku e keni ndalur punën. Mbylleni librin e testit dhe lëreni në tavolinë.

*Për pauzë 1, kujdestari juaj do të thotë:*

- Tani do të ndalemi për një pauzë 5 minuta për zgjatje të muskujve. Mos i diskutoni pyetjet e testit gjatë pauzës ose mos u largoni nga klasa e testimit pa leje.

Nuk mund t'i qaseni ose ta përdorni telefonin apo ndonjë tjetër pajisje elektronike në këtë pauzë ose ndonjë pauzë tjetër gjatë testit. Të gjithë telefonat dhe pajisjet tjera duhet të jenë të fikura dhe të vendosen larg deri në përfundim të testit.

Nëse ju jap leje të largoheni nga klasa, ndiqni këto rregulla:

- Shkoni vetëm në hapësirat e dedikuara, ose në tualet.
- Ju lutem kini konsideratë për studentët që janë duke punuar në klasat tjera dhe mos flisni në korridor.
- Nëse keni sjellë me vete zamra, mund t'i hani vetëm në zonat e dedikuara.

Do të fillojmë përsëri pas saktësisht 5 minutave.

## 2.1 Pjesa 1 Udhëzimet e Librit të Testit



Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që gjenden në fillim të Pjesës 1 të librit të testit.

---

### 55 MINUTA, 42 PYETJE (KOHJA STANDARDE)

**Kaloni në Pjesën 1 të fletës së përgjigjeve për t'u përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.**

#### UDHËZIMET

Çdo pasazh ose çift pasazhesh më poshtë pasohet nga një numër pyetjesh. Pas leximit të çdo pasazhi apo çifti pasazhesh, zgjidhni përgjigjen më të mirë për secilën pyetje duke u bazuar në çfarë është deklaruar apo nënkuptuar në pasazhin ose pasazhet dhe në ndonjë grafikë shoqëruese (siç janë tabelat apo diagramet).

---

## 2.2 Pauza mes pjesëve

*Në fund të pauzës, kujdestari juaj do të thotë:*



Ju lutem uluni në vendin tuaj. Mos e hapni librin e testit deri të mos ju them ta bëni këtë.

## 3 Pjesa 2: Testi i Shkrimit dhe Gjuhës



Koha standarde për Pjesën 2 është **30 minuta**. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të librit të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

*Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:*




Tani do të kalojmë në Pjesën 2, Testi i Shkrimit dhe Gjuhës. Pasi të fillojmë, do të keni 30 minuta për të punuar në Pjesën 2. Do t'i postoj kohën e fillimit dhe kohën e përfundimit, dhe do t'ju njoftoj kur të kalojë gjysma e kohës së pjesës dhe kur të mbeten edhe 5 minuta.

Nxirreni jashtë fletën e përgjigjeve dhe gjeni Pjesën 2 në fletën tuaj të përgjigjeve. Mos filloni punë derisa të ju them unë. Mbani fletën e përgjigjeve të hapur dhe rrafsh në tavolinë. Mos i palosni faqet prapa. Sigurohuni të shënjoni përgjigjet tuaja në Pjesën 2 të fletës së përgjigjeve dhe kontrolloni që përgjigjet e juaja të jenë në hapësirat e duhura për secilën pyetje me numër.


Nëse përfundoni para se të them se i erdhi fundi kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk duhet të kaloni në asnjë pjesë tjetër.

Tani, ju lutem hapni librin tuaj të testit të Pjesës 2. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Koha fillon tani.


